

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-49/12

Prishtinë, 8 maj 2012

Në çështjen ligjore të

N.T.

Paraqitësja e kërkesës/Pala ankuese

Kundër

L.V.

Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/131/2011 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA00109), të datë 26 tetor 2011, pas shqyrtimit të mbajtur më 8 maj 2012 mori këtë

AKTGJYKIM

- 1- Refuzohet si e pabazuar ankesa e N.T. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPKK/D/A/131/2011 për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA00109).
- 2- Konfirmohet vendimi KPKK/D/A/131/2011 për sa i takon lëndës që është e regjistruar në AKP me numrin KPA00109.
- 3- Obligohet pala ankuese që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej € 140 (njëqindë e katërdhjetë euro) brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 26 qershor 2006, N.T. (paraqitësja e kërkesës) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku ka kërkuar ri-posedimin e një shtëpie në ngastrën 519, Cetinja 19, Mitrovicë. Paraqitësja e kërkesës ka sqaruar se prona në fjalë ishte uzurpuar nga pala përgjegjëse në kërkesë L.V. në vitin 2000.

Për të mbështetur kërkesën e saj, znj. T. ka paraqitur në AKP vendimet e nxjerra nga Gjykata Komunale në Mitrovicë më 16 shkurt 1999 dhe më 18 nëntor 1998, të nxjerra në procedurën për shqiptimin e masës së përkohshme, e nxjerrë nga e njëjta gjykatë më 08 nëntor 1997.

Paraqitësja e kërkesës e ka cekur L.V. si uzurpues të pronës.

AKP-ja ka vazhduar njoftimin duke vendosur një njoftim në ndërtesën në ngastrën 519 me datën 25 tetor 2007.

Në raportin e datës 04 tetor 2011, AKP-ja (Sekretaria Ekzekutive) sqaron se Sekretaria e kishte kontaktuar paraqitësen e kërkesës më 13 shtator 2011 dhe i kishte bërë asaj pyetje shtesë. Paraqitësja e kërkesës kishte sqaruar se ajo nuk kishte qenë në posedim të përhershëm të pronës së kontestueshme që nga viti 1992, si rezultat i shkurorëzimit nga bashkëshorti i saj. Ajo kishte bërë

përpyekje që të ri-posedonte pronën në vitin 1995, por ri-posedimi kishte përfunduar pas një muaji “kur ish-kunata e saj, M., me ndihmën e policisë vendore e kishte dëbuar atë nga prona e kërkuar”.

Me vendimin grupor Nr. KPKK/D/C/131/2011, të datës 26 tetor 2011, lidhur me kërkesën 00109, KKPK-ja ka vendosur se kërkesa bie jashtë jurisdiksionit të Komisioni të përcaktuar në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079. Komisioni ka vërejtur se “paraqitësja e kërkesës pranon se e kishte humbur posedimin e pronës së kërkuar në vitin 1992 si për shkak të shkurorëzimi të saj nga bashkëshorti në atë kohë. Në këtë mënyrë, nuk mund të thuhet se humbja e pronës së paraqitëses së kërkesës është drejtpërsëdrejti e ndërlidhur ose rezulton nga konflikti i viteve 1998-1999” .

Paraqitësja e kërkesës e ka pranuar vendimin e KKPK-së me 09 shkurt 2012.

Me 24 shkurt 2012, paraqitësja e kërkesës, tani pala ankuese ka paraqitur një ankesë në Gjykatën Supreme kundër vendimit të lartpërmendur.

Pala ankuese pohon se kontesti është si pasojë e konfliktit dhe se prona ishte shfrytëzuar padrejtësisht nga pala përgjegjëse në kërkesë.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve siç parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Megjithatë, ankesa është e pabazuar. Vendimi i KKPK-së është i drejtë dhe i ligjshëm, ngase lënda nuk bie nën jurisdiksionin e KKPK-ës.

Sipas nenit 3.1 Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhër të Komisionit për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që dëshmon pronësinë e pronës së paluajtshme private, por edhe që ai nuk është në gjendje aktualisht t'i ushtrojë këto të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

Vetë paraqitësja e kërkesës ka theksuar para AKP-së se e kishte humbur posedimin ndaj pronës së kontestueshme në vitin 1992 pas shkurorëzimit nga bashkëshorti i saj në atë kohë, se e kishte riposeduar atë vetëm në një muaj në vitin 1995 dhe pas kësaj ajo përsëri ishte dëbuar nga prona nga ane e ish-kunatës me ndihmën e policisë vendore. Më sa duket, kontesti rreth pronës së kërkuar kishte filluar shumë kohë para ngjarjeve të vitit 1998 dhe 1999 dhe në asnjë aspekt kjo nuk është e ndërlidhur me konfliktin e armatosur ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Fakti se kontesti kishte filluar në një kontekst krejtësisht të pa ndërlidhur me këtë, është konfirmuar po ashtu nga dokumentet e paraqitura nga vetë paraqitësja e kërkesës-vendimi i lartpërmendur i gjykatës i lëshuar nga Gjykata Komunale në Mitrovicë më 16 shkurt 1999. Ai kishte të bënte me kontestin ndërmjet N.T. në njërën anë dhe S.T. dhe PM. në anën tjetër. Gjykata Komunale kishte vendosur se N.T. kishte të drejtën pronësore mbi gjysmën e shtëpisë, që ndodhej në ngastrën 519 në Mitrovicë, që do të thotë se kontesti lidhur me të drejtat pronësore ndaj shtëpisë në ngastrën 519 është krejtësisht i pa ndërlidhur me konfliktin e armatosur të viteve 1998-1999 dhe duhet të zgjidhet në kuadër të sistemit të gjykatave të rregullta civile.

Pasi që kërkesa është jashtë juridiksionit të KKPK-së, KKPK-ja nuk ka për detyrë që të vendos rreth pronësisë së palës ankuese/paraqitëses së përgjigjes në kërkesë.

Duke ndjekur të njëjtën linjë – për shkak të mungesës së juridiksionit, Gjykata nuk ka për detyrë që të vendos nëse pala ankuese është ose jo pronare e pronës së kërkuar.

Shpenzimet e procedurës:

Në bazë të Aneksit III, nenit 8.4 të UA 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, zbatohet regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (nenet 10.21, dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pasur parasysh se vlera e pronës së kërkuar më arsye mund të vlerësohet deri në €12000: €110 (50€ + 0,5% e €12000)

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala ankuese brenda afatit prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi i dorëzohet atij.

Këshillë juridike :

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Elka Filcheva-Ermenova, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it